



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DIMAL
KËSHILLI BASHKIAK

VENDIM
NR 18 DATË 28.02.2022

MBI MIRATIMIN E VLERËS SË PREVENTIVIT PARAPRAK PËR INVESTIMIN E OBJEKTIT "RIKUALIFIKIMI URBAN I LAGJES 4 SHTATORI" BASHKIA DIMAL NË MASËN 71 965 226,82 LEKË ME TVSH

Këshilli Bashkiak Dimal në mbledhjen e tij të datës 28.02.2022, bazuar në materialin e paraqitur nga Drejtoria e Planifikimit të Territorit, në mbështetje dhe zbatim të Ligjit Nr.139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore", i ndryshuar, Ligjin Nr.139/2015 datë 17.12.2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore", neni 8 pika 2, 9 pika 1.1.b, Neni 25, Neni 34, Neni 35, Neni 36, Neni 37, Neni 40, Neni 41, Neni 53, Neni 54 pika dh, Neni 55, Neni 64 pika c, Ligji 107/2014 datë 31.07.2014 "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit", i ndryshuar, VKM 408 Datë 13.05.2015 "Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit", i ndryshuar, Vendimi Nr 354 datë 11.05.2016 "Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikim, projektim, mbikqyrje dhe kolaudim, VKB Nr 82 datë 24.12.2021 "Për miratimin e buxhetit afatmesëm 2022-2024 dhe miratimin e Buxhetit të detajuar për vitin 2022" dhe me propozim të Kryetarit të Bashkisë

VENDOSI

Me 15 vota PRO nga 15 Këshilltarë prezentë në mbledhje të miratojë:

1. Të miratojë projekt preventivin paraprak të paraqitur për investimin në rrjetin rrugor për objektin "Rikualifikimi Urban i Lagjes 4 Shtatori" ,Njësia Ura Vajgurore, Bashkia Dimal, në masën 71 965 226,82 lekë me tvsh, sipas preventivit bashkëlidhur këtij vendimi, pjesë integrale e vendimit përkatës.

2. Të miratojë vlerën e mbikqyrjes së objektit në masën 979895 lekë me tvsh
3. Të miratojë vlerën e koladimit të objektit në masën 101368 lekë me tvsh
4. Financimi i këtij projekti do të përballohet nga fondet e Bashkisë Dimal.
5. Ngarkohet Kryetari i Bashkisë Dimal për zbatimin e këtij vendimi
6. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6, të nenit 55 të Ligjit nr 139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore", i ndryshuar.

